



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 268 Prot.

Tiranë, më datë 08.04.2022

VENDIM
Nr. 88, datë 08.04.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj” si dhe të VKM Nr. 1040, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje”, pas shqyrtimit më parë të kërkesës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Shkodër me Nr. 14033 Prot., datë 10.12.2021, administruar në Sekretarinë Teknike të IKTK-së me Nr. 1695 Prot., datë 13.12.2021 në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.04.2022:

VENDOSI:

1. Vijimin e procedurës së legalizimit të objektit me vetëdeklarues *Z. Sabri Mustafa*, në kufi të objektit pasuri kulturore të “Banesës e Myzafer Cenës”, monument i kategorisë së I-rë, në qytetin e Shkodrës;
1. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
2. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

